




VITI 2019

RAPORT VJETOR




Përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij programi janë 9 organizata anëtare të AWEN, kryesisht në 8 zona gjeografike: Peshkopi, Durrës, Tiranë, Sarandë, Pogradec, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan - ku organizatat anëtare të AWEN janë aktive, saktësisht:

- Argitra Vision (Peshkopi)
- Shoqata për Gratë e Vajzat me Probleme Sociale (Durrës)
- Linja e Këshillimit për Gra e Vajza (Tiranë)
- Shoqata 'Jona', (Sarandë)
- Shoqata 'Unë Gruaja', (Pogradec)
- Qendra Psiko-sociale “Vatra” (Vlorë)
- Gruaja tek Gruaja (Shkodër)
- Forumi i Gruas (Elbasan)
- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (Tiranë)

Gjatë 2019, u mbështetën me grante të vogla për realizimin e disa nismave advokuese 5 organizata jo-anëtare të AWEN:

- Qendra për Aksion Komunitar (Shkozë, Lanabregas, Selitë);
- Qendra FOKUS, në Tiranë dhe rrethina (Kamëz);
- Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, në Bashkinë Elbasan;
- Ura të Reja, Berat, në zonën e Urës Vajgurore;
- Strehëza për Gra e Vajza, në njësitë administrative të Bashkisë Tiranë.



17 PROJEKTE JANË REALIZUAR
GJATË VITIT 2019 NË KUADËR TË
KËTIJ PROGRAMI!

MBËSHTETJA FINANCIARE GJATË 2019 ËSHTË FOKUSUAR NË DISA KOMPONENTË DHE KA SHËNUAR ARRITJET E MËPOSHTME:

OFRIM I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR PËRFITUESET, SIÇ JANË SHËRBIMET E REFERIMIT, SHËRBIMET PSIKO-SOCIALE DHE LIGJORE, SHËRBIME STREHIMI (EMERGJENCE OSE AFATGJATË), NDËRRHYRJE RI-INTEGRUESE (ARSIMIM, FORMIM PROFESIONAL, NDËRMJETËSIM PËR PUNËSIM, ETJ).

- Në total, **rreth 1700 vajza e gra të mbijetuara të dhunës në familje kanë marrë mbështetje direkte dhe asistencë** me shërbime të specializuara për përfitueset;
- Linja Kombëtare 116 117 u është përgjigjur **3014 telefonatave** për mbështetje e informacion dhe ka ofruar **këshillim ballë për ballë për 1168 raste**;
- **Rreth 1506 referime rastesh për dhunë në familje** janë menaxhuar nga AWEN dhe anëtarët;
- Të paktën **49 burra dhunues kanë përfituar nga shërbimet rehabilituese**.
- **50 gra janë punësuar apo vetëpunësuar** përmes mbështetjes direkt apo ndërmjetësimit për punësim;

KRIJIMI DHE FORCIMI I GRUPEVE TË VAJZAVE DHE GRAVE NË KOMUNITET

- Të paktën **20 zona të reja** janë prekur nga ndërhyrjet e AWEN dhe anëtareve në terren;
- Të paktën **18 grupe të reja grash/ komunitare** janë ngritur në zona të reja;
- Janë realizuar dhjetëra aktivitete për ngritjen e kapaciteteve që synojnë aktorët kryesorë vendorë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave.
- Të paktën **1092 aktorë vendorë** janë ndërgjegjësuar e fuqizuar gjatë vitit 2019 nga AWEN dhe organizatat anëtare;
- **23 Mekanizma Referimi dhe 13 njësi administrative** janë mbështetur nga organizatat anëtare për menaxhimin e rasteteve të dhunës në familje;



NISMA LOBUESE DHE ADVOKUESE QË SYNOJNË MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË GRAVE

- Fuqizim social-ekonomik i 76 grave nga Komuniteti Rom dhe regjistrim i 30 fëmijëve në institucionet arsimore parësore përmes projekteve të vogla të advokacisë.
- Identifikimi i qasjeve efektive për të parandaluar dhunën në marëdhëniet intime (DHMI) dhe dhunën seksuale midis adoleshentëve;
- Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen lokale në Urë Vajgurore;
- Rritje e bashkëpunimit midis strukturave të policisë dhe shërbimeve sociale lidhur me procedurat e vlerësimit të rrezikut dhe monitorimin e urdhrave të mbrojtjes për viktimat e DhF dhe DhBGj;
- Fuqizim i grupeve të grave për të monitoruar dhe advokuar në nivel lokal dhe rritje e përgjegjshmërisë institucionale të Mekanizmave të Referimit në Pogradec.

FUSHATA INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE

MË POSHTË ËSHTË NJË PËRMBLEDHJE E SINTETIZUARE E NJË PUNE 12 MUJORE E AWEN DHE ANËTAREVE NË KOMUNITET, MBËSHTETUR NGA AWEN/SIDA



- **Të paktën 8513 gjithsej (gra dhe vajza, djem dhe burra) janë më të vetëdijshëm për të drejtat e grave** duke marrë pjesë në aktivitete ndërgjegjëse e informuese të AWEN dhe organizatave anëtare gjatë vitit 2019; **Mes tyre, 2459 të rinj të shkollave të mesme** janë ndërgjegjësuar e informuar rreth dinamikave të dhunës në marrëdhëniet intime në adoleshencë, bazuar në gjetjet e studimit kombëtar të AWEN (2018);
- **Rreth 100.000 qytetarë janë ndërgjegjësuar** nëpërmjet fushatave kombëtare në media, evente ndërgjegjëse në publik, manifestime e protesta;
- **Rreth 140 vajza dhe djem të rinj janë angazhuar si aktivistë / vullnetarë** përkrah AWEN dhe organizatave anëtare gjatë vitit 2019;
- **Dhjetëra aktivitete ndërgjegjëse** zhvilluar gjatë muajit mars 2019 – Muaji i Gruas dhe gjatë 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore: 25 Nëntor–10 Dhjetor 2019;
- **Manifestime e tubime paqësore** ndërgjegjëse;
- **Forume/Seminare** rreth dhunës me bazë gjinore e pabarazive gjinore me nxënës e studentë;
- **Pjesëmarrje në emisione televizive e radiofonike** në Tiranë e rrethe;
- **Shpërndarje materiale**sh ndërgjegjëse;
- **Kontakt derë më derë në terren/ zona rurale**;
- **Evente artistike e sportive** ndërgjegjëse;
- **Fushata në shkolla** 9-vjeçare e të mesme;
- **Performanca në rrugë (street activism)** nga të rinjtë në qytete të ndryshme;
- **Forume ndërgjegjëse** me vajza e gra;



KONTRIBUTE TË AWEN DHE ANËTAREVE NË LOBIM DHE ADVOKACI

KËSHILLI KOMBËTAR I BARAZISË GJINORE

KONTRIBUT NË PËRMIRËSIM LIGJESH E POLITIKASH VENDORE E KOMBËTARE

REAGIME PUBLIKE NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË VAJZAVE E GRAVE

- Pjesëmarrje dhe kontribut në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore.
- Kontribut në tryezat konsultuese lidhur me ligjet dhe politikat që adresojnë të drejtat e vajzave dhe grave në Shqipëri;
- Input-e zyrtare dhe rekomandime për komisionin e CEDAW, dhe Parlamentarë Evropianë, MShMS, Bashkitë, Komisionet Parlamentare, Ministrinë;

- Kontribute për Raportin e Delegacionit i BE-së në Shqipëri për vitin 2019, lidhur me të drejtat e vajzave e grave;
- Pjesëmarrje dhe kontribut në dëgjesat/seancat e Kuvendit dhe Komisioneve Parlamentare rreth Dhunës ndaj Vajzave e Grave;
- Letra të Hapura drejtuar publikut të gjerë, mediave, hartuesve të politikave e ligj-zbatuesve;
- AWEN është pjesë e grupit të punës në monitorimin e Planit të Veprimit për Rezolutën 1325.

STUDIME: GJATË VITIT 2019 U BË LANÇIMI I STUDIMIT KOMBËTAR 'DHUNA NË MARRËDHËNIET INTIME NË ADOLESHENCË' NË SHQIPËRI.
PËR MË SHUMË VIZITONI: [HTTPS://AWENETWORK.ORG/STUDIME/](https://awenetwork.org/studime/)

PROJEKTE TË TJERA – 2019

PLANI GJINOR I VEPRIMIT, ZBATUAR NGA AWEN QË PREJ SHKURTIT 2019, NË KUADËR TË PSHM - PROJEKTI PËR SHËRBIMET MJEDISORE - MBËSHTETUR NGA SIDA/BANKA BOTËRORE


Qëllimet kryesore të projektit:

-> Rritje e aksesit të grave në vendimmarrjen në Shoqatat e Pyjeve dhe Kullotave në zonat Jugore dhe Qendrore të Shqipërisë,

-> Përmirësimi i mundësive të grave dhe të rinjve për të rritur kapacitetet dhe informacionin rreth Barazisë Gjinore /Shërbimeve Mjedisore dhe për të rritur ndërgjegjësimin rreth rezultateve pozitive lidhur me barazinë gjinore në organet e pushtetit lokal përkatëse siç janë NJQV-të.

Si rezultat:

- Janë zhvilluar 24 trajnime rreth barazisë gjinore;
- 7 trajnime dhe workshope me grupet e synuara në zhvillim projektesh;
- Janë zhvilluar 2 aktivitete për shkëmbim eksperiencash;
- Janë zhvilluar 3 trajnime për planet zhvillimore të biznesit;
- 8 seminare dhe aktivitete për të ndërtuar lidhjet mes Shoqatave të Pyje Kullotave dhe Këshillave Bashkiake;
- 2 trajnime për rishikimin e statuteve të Shoqatave të Pyjeve dhe Kullotave;
- 1583 gra e burra kanë qenë pjesë e aktiviteteve fuqizuese, 45% e tyre gra.



PROJEKTI "ADVOKIM PËR BARAZINË GJINORE DHE PROCESET E INTEGRIMIT NË BE", MBËSHTETUR NGA KVINNA TILL KVINNA



- **8 aktivitete ndërgjegjësuere u organizuan në Tiranë, Sarandë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Peshkopi dhe Durrës** në bashkëpunim me organizatat anëtare të AWEN ku morën pjesë më shumë se 50 përfaqësues të MKR-ve në nivel vendor;
- **6 takime informuese dhe advokuese** rreth politikave gjinore të BE-së, u zhvilluan nga Qendra Psiko – Sociale “Vatra” dhe AWEN në bashkëpunim me Aleancat e Grave Këshilltare të Vlorës Himarës dhe Selenicës;
- **Forum me 24 djem dhe vajza në Shkodër** rreth të drejtave të grave si të drejta të njeriut, parë nga perspektiva e BE-së, organizuar nga Gruaja tek Gruaja, Shkodër;
- Aktiviteti **‘16 vullnetarë përgjate 16 ditëve’** me të rinj e të reja të shkollave të mesme, organizuar nga ‘Unë Gruaja’, Pogradec.
- 55 të rinj të shkollave të mesme morën pjesë në aktivitetin ndërgjegjësuere dhe artistik **#EqualisBetter** organizuar nga Forumi Gruas Elbasan në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan dhe Drejtorinë Rajonale të Arsimit;
- **1 workshop me 30 përfaqësues të pushtetit vendor** u organizua nga ‘Gruaja Paqja Siguria’, Durrës rreth rëndësisë së zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit të Rezolutës 1325;
- **4 takime informuese dhe advokuese** janë organizuar në Sarandë, Peshkopi, Elbasan dhe Durrës nga anëtarët e AWEN që punojnë në këto zona me 49 përfaqësues të Mekanizmave të Referimit;
- **8 seminare rreth** çështjeve të barazisë gjinore, integrimit gjinor, legjislationit dhe instrumenteve të BE-së rreth barazisë gjinore, etj, ku morën pjesë 82 përfaqësues të OSHC-ve lokale në Tiranë, Sarandë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Peshkopi dhe Durrës;

**AWEN
KA MARRË PJESË
AKTIVISHT E KA
DHËNË KONTRIBUT NË
KONSULTIME E
TAKIME
ADVOKUESE E
LOBUESE NË KUADËR
TË PROCESIT TË
INTEGRIMIT NË BE NË
PERSPEKTIVËN E
BARAZISË GJINORE.**

**NË BASHKËPUNIM ME
‘GRUAJA PAQJA,
SIGURIA’ DURRËS DHE
KOALICIONIN 1325,
AWEN KA QENË PJESË
DHE KA MBËSHTETUR
PROCESIN E
MONITORIMIT TË
ZBATIMIT TË PLANIT
KOMBËTAR TË
VEPRIMIT PËR
REZOLUTËN 1325 NË
SHQIPËRI.**

**AWEN FALENDERON TË GJITHË
BASHKËPUNËTORËT PËR KONTRIBUTIN E TYRE
NË MBËSHTETJE TË GRAVE E VAJZAVE NË TË
GJITHË SHQIPËRINË GJATË VITIT 2019,
SI DHE SHPREH MIRËNJOHJEN E THELLË PËR
QEVERINË SUEDEZE QË VAZHDON TË BESOJË
TEK NE DUKE NA MBËSHTETUR NË VAZHDIMËSI
PËRGJATË 2019-2021!**

FALEMNDERIT!